

VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 25 tetor 2005 | nr. 10 | www.vetevendosje.org



F - U N D

Gëzim Krasniqi

Administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut u vendos në Kosovë nën kushtin e mohimit të lirisë dhe vetëvendosjes për popullin tonë. Dhe në mënyrë që të arsyetohet sundimi jodemokratik dhe antipopullor, menjëherë u mor qëndrimi që banorët vendas të përulën në nivelin e njerëzve të paqytetëruar dhe të paedukuar - veprim ky që ka shoqëruar pothuajse të gjithë administrimet koloniale pashmangshmërisht. Kështu, në Kosovë u krijua një praktikë e sundimit neokolonialist. Si i tillë ajo vazhdon të ekzistojë akoma. Por për të arritur të amortizojë dhe të shuajë krejtësisht revoltën popullore dhe kërkesën fundamentale të qytetarëve për liri dhe vetëvendosje, regjimit politik në vendin tonë po i vjen në ndihmë aparati i vet i dhunës dhe represionit. Në këtë mënyrë mund të shpjegohet edhe përdorimi në rritje i dhunës së policisë së SHPK-së dhe asaj të UNMIK-ut ndaj aktivistëve të lëvizjes Vetëvendosje! dhe qytetarëve të Kosovës në përgjithësi.

Aksioni i paraditshëm i aktivistëve të Vetëvendosje!-s, që akronimit 'UN' në veturat e zyrtarëve ndërkombëtarë, t'iu shtohen edhe shkronja F në fillim, dhe ajo D në fund, që kështu t'i thuhet FUND sundimit dhe shtypjes së UNMIK-ut, regjimi iu përgjigj me dhunë dhe brutalitet policor. S'ka dyshim që një gjë e tillë nuk është më befasi në Kosovë, kur kihet parasysh praktika e mëhershme, dhe çka është më me rëndësi, karakteri i regjimit politik në vendin tonë. Brutaliteti dhe dhuna që po ushtron aparati policor nën komandën e UNMIK-ut, fundja, është

vetëm shprehje e jashtme e strukturës jodemokratike dhe shtypëse, e që shprehet në sjelljet e tij. Dhuna dhe shtypja janë reagim 'i kuptueshëm', përcaktuar me vetë natyrën e gjërave - sundimin jodemokratik të administratës ndërkombëtare në Kosovë. Me sjelljet e tij, UNMIK-u dhe aparati i tij policor po i nënshtrohen verbërisht ligjeve dhe natyrës së tyre. Gjashtë vjet më shumë shtypje dhe mungesë lirie për një popull, s'janë pak. Andaj s'ka fije dyshimi që çdo ditë është koha që populli t'i thotë fund regjimit jodemokratik ndërkombëtar në Kosovë. Koha t'i thuhet fund shtypjes dhe mungesës së lirisë e mundësive për zhvillim të përgjithshëm shoqëror në Kosovë. Fund UNMIK-ut, sepse çdo ditë jete për të do të thotë një ditë më shumë shtypje dhe mungesë lirie në Kosovë. Sepse me këtë i thuhet fund praktikave të sundimit totalitarist dhe autoritar, kufizimit të demokracisë dhe lirisë qytetare. Fund korupsionit galopant që ka përfshirë institucionet politike të Kosovës me në krye UNMIK-un, zhytjen e thellë në korupsion të të cilit e konstaton edhe vetë Autoriteti Mbikëqyrës i OKB-së në një raport të tij të kohëve të fundit. Është pikërisht ky raport që shpërfaq lakuriq para të gjithëve karakterin dhe natyrën reale (përvetësuese dhe shfrytëzuese) të administratorëve ndërkombëtarë në Kosovë, nivelin e lartë të korruptimit të tyre. Krejt kjo në kurriz të popullatës së varfëruar vendase. Fundi për UNMIK-un nënkupton çrrënjosjen nga themeli të strukturave të korruptuara, që po mbajnë peng zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Fund për regjimin e UNMIK-ut që vazhdimisht flet për paqen,

demokracinë, njeriun e lirë dhe të drejtat e tij, e njëherazi e shtyp atë pandërprerë dhe për çdo kund. Fund për strukturat e burokracisë së tepërt, që në vend se të ofrojnë shërbim civil për qytetarin, praktikojnë rropatjen e tij të panevojshme dhe, si rezultat, torturojnë atë psikikisht. Fund UNMIK-ut, menjëherë dhe pa kushte. Jo vetëm kaq. Fund edhe mundësisë së vendosjes së çdo regjimi tjetër dhe administrate tjetër neokolonialiste në Kosovë. Afërmendësh, FUND nuk është fjala magjike për zgjidhjen e të gjitha problemeve në Kosovë. Është kushti i domosdoshëm për realizimin e lirisë qytetare dhe nevojës imante për të vendosur vetë për të ardhmen. Ndryshimi i regjimit jodemokratik dhe mohues të lirisë qytetare, nuk bëhet me reforma dhe përmirësim të marrëdhënieve ekzistuese, sepse këto marrëdhënie akoma mbesin marrëdhënie në mes shtypësit dhe të shtypurit. Rrjedhimisht, fundi i regjimit është i domosdoshëm për të ndryshuar marrëdhëniet shoqërore. Është kushti ekzistencial për ndryshimin rrënjësor, zhvillimin e vendit dhe progresin e gjithëmbarshtëm shoqëror. Në anën tjetër, fundi i shtypjes dhe mohimit të lirisë në Kosovë, në asnjë mënyrë nuk nënkupton fundin e përpjekjeve të popullit në angazhimin për zhvillim dhe prosperitet. Përpara nesh mbetet sfida e madhe e krijimit të vlerave të reja të një shoqërie demokratike dhe të lirë për të gjithë pjesëtarët e saj. Mbetet sfida e madhe e krijimit të një sistemi politik jashtë çdo mundësie për të imituar, qoftë edhe në margjina, sistemin politik aktual.

Populli dinjitoz dhe i lirë është populli sovran.
Populli dinjitoz është populli i përgjegjshëm.
Franc Fanon

Editorial

Le ta themi pa ndrojtje që në fillim: në Rambuje, delegacioni shqiptar nënshkroi një marrëveshje, pikat kryesore të së cilës janë në kundërshtim me ato që, ky delegacion, në vërejtjet fillestare që ua kishte kaluar bashkëkryesuesit dhe negociatorëve të Marrëveshjes, i kishte ekspozuar si qëllime fundamentale jo vetëm të tij, por të krejt popullit shqiptar të Kosovës. Ishte ky delegacion që vuri nënshkrimin në një dokument, pika e katërt e të cilit, synimin themelor të bashkësisë ndërkombëtare dhe garantuesve të zbatimit të marrëveshjes, e artikulonte si ruajtje e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës Federative të Jugosllavisë, që si e tillë gjendet si e pesta edhe te parimet e panegociueshme të Grupit të Kontaktit. Kjo pikë duket të jetë vendimtare në përcaktimin e natyrës së pikave tjera pasardhëse. Ja përse pika shtatë e Marrëveshjes nuk njeht popullin e Kosovës si faktor vendimtar në përcaktimin e fatit të tij, duke e zëvendësuar këtë kategori me atë të bashkësive nacionale. Krejt përputhshëm, pika e pestë e kapitullit të parë të Kushtetutës parasheh përfaqësimin që institucionet e Kosovës u bëjnë bashkësive nacionale, pa u përmendur askund termi popull. Marrëveshja përmbyllet me kapitullin e tetë, pjesa e tretë e nenit të parë të të cilit, pas një periudhe trevjeçare prej hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, garanton mbajtjen e një mbledhjeje ndërkombëtare "për të përcaktuar një mekanizëm për zgjidhjen finale për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit (...)", pa e specifikuar se për cilin popull është fjala. Dhe, jo vetëm kaq: për ata që vërtetë vuajnë nga një miopi serioze, krejt në fund të Marrëveshjes, garantuesit e saj janë përkujdesur me një zell të jashtëzakonshëm që të jenë tri palë nënshkruese, e jo dy - Republika Federale e Jugosllavisë, Republika e Serbisë dhe Kosova. A s'është kjo e përputhshme me kalimin e të drejtës së të qenit suksesor, që Serbia do të mund ta ketë ndaj Kosovës, sipas Kushtetutës së Unionit Serbi - Mal i Zi, dokument ky i njohur, bile edhe i krijuar ndërkombëtarisht pikërisht në momentin kur shumica prej nesh po prisnim aq të shumëpritur referendum, të cilin na e kishin premtuar nënshkruesit e Rambujesë pas kalimit të periudhës trevjeçare?

Është dashur, apo s'është dashur të nënshkruhet Marrëveshja e Rambujesë? Nëse argumenti kryesor pse na qenka dashur të nënshkruajmë është hipoteza se, po të mos e bënim këtë, rrezikonim të mbeteshim peng i raportit të forcave ndaj kundërshtarit, gjë që do të rezultonte me kërcënimin e rrezikut për farosje totale, atëherë si është e mundur që ka aq shumë shembuj nga popujt, rrjedha e konfliktit ndërmjet të cilëve nuk ka qenë e përcaktuar aspak nga ky raport? Në anën tjetër, po që se tërë veprimet e bashkësisë ndërkombëtare në këto pesë vitet e fundit kanë ndjekur kryesisht vijën e përpjekjeve për integrimin e Kosovës në krijesën e brishtë të quajtur Union Serbi-Mal i Zi, atëherë ku qëndroka arsyeja e nënshkrimit të dokumenteve të pafavorshme, ndërkohë që presim nga mrekullia që marrëdhëniet ndërkombëtare ta ndjekin logjikën e vullnetit të popujve, e jo inercionin e rrejtë të dokumenteve ndërkombëtare? Nëse frika se UÇK-ja do të shpallej organizatë terroriste, veprim që për Milloshevićin mund të shërbente si sinjal për ndërmarrjen e ofanzivave të tmerrshme, atëherë, ku qëndron një arsytim i tillë, kur dihet fort mirë që, shpallja e po kësaj organizate si grup "terrorist" nga Robert Gellbardi, s'i paraqiti aspak problem bashkëkombasit të tij, Richard Holbrookeit që më pas të takohej me përfaqësues të këtij grupi, tashmë "gueril"?

Gjithsesi, fare në fund, duhet cituar një mendim fort të arsyeshëm të filosofit të madh gjerman, Imanuel Kant "Asnjë vendim për paqe, nuk duhet vlejë si i tillë, nëse fsheh brenda një rezervë, e cila mund të japë lëndë të mjaftueshme për ndonjë luftë të ardhme" (Immanuel Kant, Paqja e përyetshme, seksioni I, pjesa 1, fq. 68).

Glauk Konjufca

MARRËVESHJA E RAMBUJESË PËRBALLË REZOLUTËS 1244

Shkëlzen Gashi

HYRJE

Që në fillim duhet thënë se Marrëveshja e Rambujesë në tërësi e përbajtur në Rezolutën 1244, dhe kjo rezolutë, siç do të elaborohet më tutje, i referohet Marrëveshjes së Rambujesë. Në vijim të kësaj, nuk mund të kuptohet se çfarë përmban Rezoluta 1244, pa e kuptuar se çfarë përmban Marrëveshja e Rambujesë. Pra, në Rezolutën 1244, në njëfarë mënyre, tregohet shkurtimisht se çka përmban Marrëveshja e Rambujesë. Fakti se ka ekzistuar dyshimi në mesin e shumicës së pjesëtarëve të delegacionit kosovar për nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë - këtu më duket e arsyeshme ta kujtoj pyetjen (e cila njëkohësisht ishte edhe kërkesë) që kryesuesi i delegacionit kosovar në Rambujë i bën shkrimtarit tonë të mirënjohur, Ismail Kadaresë, në një takim në shtëpinë e këtij të fundit, më 18 mars 1999 - "në rast se sonte e nënshkruaj marrëveshjen, ju si shkrimtar shqiptar, a do ta përkrahni këtë akt publikisht?" - flet më së miri se sa e vështirë ka qenë marrja e vendimit për ta nënshkruar këtë marrëveshje kontradiktore dhe të dëmshme për interesin nacional të Kosovës. Madje, po ashtu, edhe akuzat pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga ithtarët e idesë së mosnënshkrimit të saj, dëshmojnë për një gjë të tillë.²

Derisa serbëve u është thënë nga ndërkombëtarët që, nëse nuk e nënshkruajnë marrëveshjen, do të bombardohen, shqiptarëve u është thënë se, në qoftë se dëshitmi do të vinte për fajin e tyre, atëherë, do t'i linin nën mëshirën e forcave të sigurimit dhe paraushtarakëve serbë. Me fjalë të tjera, të dyja palëve u është thënë: "Nënshkruaj ose vdis!"³ Qëllimi kryesor i kësaj eseje është që të paktësojë ngritjet dhe rënitë për Kosovën në Rezolutën 1244 përballë Marrëveshjes së Rambujesë - nëse veç ekziston ndonjë ngrije apo rënie për Kosovën. Mirëpo, para se të kalojmë te pjesa kryesore e kësaj eseje, është me rëndësi të jepet një historik i shkurtër në lidhje me Marrëveshjen e Rambujesë dhe Rezolutës 1244.

HISTORIKU I SHKURTËR

Siç dihet, pas masakrës së Reçakut (15 janar 1999), bashkësia ndërkombëtare do të intensifikojë përpjekjet e saj për zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe kulminacioni i këtyre përpjekjeve do jetë Konferenca e Rambujesë (6 - 23 shkurt dhe 15 - 18 mars 1999), ku Marrëveshja e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë do të nënshkruhet vetëm nga pala kosovare, por jo edhe nga ajo serbo-jugosllave. Si rrjedhojë e mosnënshkrimit nga pala serbo-jugosllave paskëtaq do të pasojë intervenimi i NATO-s (24 mars 1999), i cili do të kurorëzohet fillimisht me Planin e G8, të cilin me 3 qershor e ka miratuar Parlamenti i Serbisë dhe Presidenti Millosheviq dhe më pas me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së (10 qershor 1999). Pra, intervenimi i NATO-s ka ndodhur për shkak të mosnënshkrimit të marrëveshjes nga pala serbe, e jo për shkak të nënshkrimit të marrëveshjes nga pala shqiptare. Jo për të çliruar apo pavarësuar Kosovën, siç pretendojnë pjesa dërmuese e politikanëve kosovarë dhe posaçërisht nënshkruesit e Delegacionit të Kosovës në Rambujë, por për t'i sjellur Kosovës paqe dhe për

ta ruajtur sovranitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë...

PJESA KRYESORE

Mjerisht, kur është hartuar Rezoluta 1244, nuk është marrë parasysh krijimi i një realiteti të ri në Kosovë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Rambujesë - pra, nuk është marrë parasysh një parim, që në të drejtën ndërkombëtare njihet si Rebus sic stantibus (parim, sipas të cilit marrëveshja është e detyrueshme për palët vetëm derisa të mos ndodhë ndonjë ndryshim qenësor i rrethanave, që kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së saj).⁴ Andaj, mund të thuhet se respektimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së sipas Rezolutës 1244 derivon nga Parimet e panegociueshme të Rambujesë, por edhe nga Marrëveshja e Rambujesë, së cilës i referohet Rezoluta 1244.⁵ Është me rëndësi të thuhet se ka pasur mjaft paqartësi rreth asaj se a i referohet Rezoluta 1244 tërësisht Marrëveshjes së Rambujesë apo - siç është shkaktuar huti në opinion - vetëm aneksit 2 të Marrëveshjes së Rambujesë. Profesori serb, Radoslav Stojanović, thotë se në versionin original të Rezolutës 1244 thuhet "taking full account of annex 2 of the Rambouillet accords", por, në fakt ai e ka harruar një "and", sepse aty thuhet "taking full account of annex 2" and (stërtheksimimi - Sh.G) of the Rambouillet accords". Ç'është më e keqja, si pasojë e Marrëveshjes së Rambujesë dhe më pastaj Rezolutës 1244, tani në Tekstin e Marrëveshjes së Unionit Serbi-Mali i Zi, thuhet decidivisht se "në rast se Mali i Zi shkëputet nga Unioni, dokumentet ndërkombëtare që lidhen me FRY-në, posaçërisht Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, do të lidhen në tërësi me Serbinë si suksesor".⁶

Pra, siç u përmend edhe më sipër, Rezoluta 1244 garanton respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së dhe kjo garancë derivon nga dhjetë Parimet e panegociueshme (Non-Negotiable Principles) të Rambujesë, konkretisht nga parimi i pestë, "integriteti territorial i Republikës Federative të Jugosllavisë dhe fqinjve të saj".⁹ Këto parime janë pranuar nga pala kosovare, sepse pranimi i tyre ka qenë parakusht për të marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë. Por, çmeritës është fakti se si kërkesën fare të panevojshme të Delegacionit Serbo-Jugosllav, që pala kosovare t'i nënshkruaj këto parime, Delegacioni i Kosovës e hedh poshtë me arsyelimin se ruajtja e tërësisë tokësore të RFJ-së paraqet paragjykim të bisedimeve mbi statusin përfundimtar të Kosovës pas periudhës kalimtare trevjeçare. Kjo është kundërtënëse, sepse pikërisht këtë që Delegacioni i Kosovës e ka quajtur paragjykim të statusit përfundimtar të Kosovës, e ka pranuar me vetë shkuarjen e tij në Rambujë. Sipas Delegacionit të Kosovës rrjedh se Delegacioni i Kosovës e ka paragjykuar statusin përfundimtar të Kosovës, sepse i ka pranuar parimet e panegociueshme, pranimi i të cilave, siç u tha më sipër, ka qenë parakusht për të marrë pjesë në Konferencën e Rambujesë.

Se çfarë përmban kjo marrëveshje në të vërtetë, s'është thënë asnjëherë saktë nga nënshkruesit e saj. Në fakt, s'është thënë nga nënshkruesit e delegacionit kosovar, se nga dy nënshkruesit ndërkombëtar është thënë saktë se çfarë përmban ajo sepse këta të fundit

shkruajnë për të thënë të vërtetën ashtu si e mendojnë, e jo sikur disa nga nënshkruesit e delegacionit kosovar, për të thënë se është nënshkruar diçka që e garanton atë për të cilën kemi luftuar që sa vite. Për më keq se kaq, kjo marrëveshje edhe krahasohet me aktin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912.¹⁰ Për shembull, pika 3 e nenit 1 të Kapitullit 8 të Marrëveshjes, është pika që më së shumti është përfolur. Në këtë pikë thuhet "Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, do të mbahet një mbledhje ndërkombëtare për të përcaktuar një mekanizëm për zgjidhjen finale për Kosovën, në bazë të vullnetit të popullit...". Këtu ndalen shumica e anëtarëve të delegacionit kosovar dhe nuk e marrin në konsideratë këtë pjesën tjetër në vijim - e, po ashtu, nuk e potencojnë asnjëherë se në marrëveshje nuk specifikohet se kemi të bëjmë me vullnetin e popullit të Kosovës¹¹ - "...të mendimeve të autoriteteve relevante, të përpjekjeve të secilës palë në lidhje me implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe të Aktit Final të Helsinkit, dhe që të bëhen vlerësimet e përgjithshme mbi implementimin e kësaj marrëveshjeje, duke i marrë parasysh propozimet nga cilado palë për masat shtesë". Jim O'Brien, kryejurist amerikan dhe i Grupit të Kontaktit, e ka pranuar pjesërisht propozimin e palës kosovare që të ndryshohet kjo pikë, ose thënë ndryshe, ka pranuar që të bëhen ndryshime kozmetike. Pra, është pranuar që "pikëpamjet e popullit" të zëvendësohet me "vullnetin e popullit", por, s'është pranuar që "mbledhje ndërkombëtare" të zëvendësohet me "konferencë ndërkombëtare" dhe - ajo që është me rëndësi - mja - s'është pranuar që të "vullneti i popullit" të specifikohet se kemi të bëjmë me "vullnetin e popullit të Kosovës".¹² Në vend të kësaj, sekretarja amerikane e shtetit, Madeleine Albright, në letrën që shkruan për delegacionin e Kosovës, ndër alia, thotë se këtë propozim e konsiderojmë si konfirmim të së drejtës së popullit të Kosovës për të mbajtur një Referendum për statusin final të Kosovës pas tre vjetësh.¹³ Për më tepër, Marc Weller, njëri ndër këshilltarët e delegacionit kosovar në Rambujë dhe ekspert i shquar i së drejtës ndërkombëtare, në esenë e tij, "The Rambouillet Conference in Kosovo" botuar në International Affairs, në lidhje me letrën e sekretares amerikane thotë se "Shtetet e Bashkuara mbajtën qëndrimin se propozimi ishte i vlefshëm vetëm në qoftë se Kosova e nënshkruante marrëveshjen brenda afatit".¹⁴ Por, për fat të keq, edhe sikur delegacioni kosovar ta nënshkruante marrëveshjen brenda afatit, propëseparë, Rezoluta 1244 do t'i referohej vetëm Marrëveshjes së Rambujesë, e jo edhe letrës së sekretares amerikane të shtetit. Ky dokument, pra, letra e sekretares Albright, nuk do të kishte asnjë vlerë detyruese juridike.¹⁵ Po ashtu, është me rëndësi të citohet edhe ajo që ka thënë ambasadori amerikan Christopher Hill për "referendumin": "...Vullneti i popullit... Ne ua shpjeguam serbëve se kjo do të jetë pjesë e procesit të përgjithshëm. U thamë se do të mund të kemi gjithashtu një referendum në Serbi... Prandaj, thënë sinqerisht, referendumi nuk do të jetë përcaktues, kjo do të jetë një çështje, e cila nuk do të zgjidhet asgjë. Kështu ne do ta analizojmë situatën e përgjithshme se si po e

respektonin palët marrëveshjen ekzistuese, provizionet për jodhunë, Marrëveshjen e Helsinkut, etj. Dhe se për këtë arsye, organizimi i referendomit nuk do të ishte dëmtes për Serbinë..."¹⁶

Sa i përket "referendumi", edhe Wolfgang Petritsch dhe Robert Pichler, në librin e tyre "Rruga e gjatë në luftë - Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare", e thonë të njëjtën gjë: s'ka pasur Referendum!¹⁷ Po këta autorë thonë se shqiptarët kanë qenë të detyruar të heqin dorë nga kërkesat e tyre themelore - t nga kërkesa që për ta ka qenë conditio sine qua non - pavarësia e Kosovës, e kjo do të thotë se kosovarëve do t'u duhej t'i varrosnin shpresat për pavarësi dhe UÇK-ja do të duhej të kryente çmilitarizimin e vet. Se me nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë është hequr dorë nga pavarësia e Kosovës, e ilustron edhe thirrja që sekretarja amerikane e shtetit, Madeleine Albright, i bën delegacionit kosovar: "Ne nuk po ju kërkojmë që të heqni dorë nga ëndrrat tuaja, por që të tregoheni pakëz më realistë".¹⁸

Për fat të keq, në Marrëveshjen e Rambujesë janë disa dispozita të cilat e lidhin Kosovën me Serbinë, si për shembull, te kapitulli 1, neni 1: Parimet e Vetëqeverisjet Demokratike në Kosovë, pika 4, pastaj pika 7 (a, b, c, d dhe e) ku thuhet se qytetarët dhe bashkësitë nacionale¹⁹ në Kosovë kanë të drejtë t'i bëjnë thirrje institucioneve përkatëse të Republikës së Serbisë për qëllimet si: ndihmë në përpilimin e planprogrameve dhe standardeve shkollore; participim për programet e ndihmës sociale; Republika do të ketë detyrime të përcaktimit e latimeve dhe detyrimeve tjera për qytetarët që kërkojnë shërbime konform me këtë paragraf... Madje, njëri ndër ekspertët e delegacionit shqiptar në Rambujë, në një ese të tij - "Uti Possidetis Juris: From Rome to Kosovo", expresis verbis, thotë:

"Ua kam tërhequr vërejtjen disave nga negociatorët politikë të Kosovës në bisedimet e Rambujesë (shkurt 1999), se e tërë energjia e liderëve të Kosovës duhej të orientohej në eliminimin e atyre dispozitave të Marrëveshjes së Rambujesë, të cilat flasin për Republikën e Serbisë dhe integritetin e saj territorial, pasi integriteti territorial i RFJ (Serbi Mali i Zi) as që mund të ishte objekt diskutimi aty (këto dispozita kanë qenë dhe mbeten të panegociueshme dhe janë pjesë e pandarë e procesit të Rambujesë). Kjo gjë, mjerisht, nuk ka ndodhur si pasojë e orientimit të liderëve tanë kryesisht ndaj dispozitave për zgjedhjen e gjyqtarëve, formimin e Kuvendit të Kosovës, zgjedhjen e Kryetarit të ardhshëm të Kosovës, e kështu me rradhë".²⁰

Në Kapitullin e tetë dhe të fundit, neni 2, pika 2, thuhet se "kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të dokumentit nga Republika Federale e Jugosllavisë, Republika e Serbisë (nënvizimimi - Sh.G.) dhe Kosova. Te Kapitulli 1, neni 2, pika 1, thuhet se Kosova do ta ketë Kuvendin, i cili do të përbëhet nga 120 anëtarë, ku tetëdhjetë anëtarë zgjedhen drejtpërdrejtë, kurse dyzet anëtarë të tjerë do të zgjedhen nga anëtarët e bashkësive nacionale të Kosovës. Ndërkaq, pika 10 thotë se Kryetari i Kuvendit nuk do të jetë nga e njëjta bashkësi nacionale e Presidentit të Kosovës. Për më keq se kaq, përveç që është dashur që kosovarët të përfaqësohen me 10 deputetë në Dhomën

e Qytetarëve të Kuvendit Federal, po ashtu është dashur që të përfaqësohen me 20 deputetë në Kuvendin Nacional të Republikës së Serbisë (stërtheksimimi).²¹

Më sipër u përmendën bashkësitë kombëtare: në dokumentin e Rambujesë edhe shqiptarët, sikurse të tjerët, përfshirë serbët, romët, turqit... konsiderohen si bashkësi nacionale.²² Rrjedhimisht, është e kotë thirrja e palës kosovare në pikën 3 të nenit 1 të Kapitullit 8 të Marrëveshjes së Rambujesë, sepse kjo pikë i referohet jo vetëm vullnetit të popullit, por, veç tjerash, edhe Aktit Final të Helsinkut²³, e ky akt e garanton vetëvendosjen, por, vetëvendosjen e popujve, e jo të bashkësive nacionale. Të gjitha këto e demantojnë pohimin se "Konferenca e Rambujesë krijoi bazën legale për njohjen ndërkombëtare të të drejtës për vetëvendosje të popullit të Kosovës dhe shënon një hap përpara drejt pavarësisht të Kosovës".²⁴

Në pikën 6 të aneksit 1 të Rezolutës 1244, por edhe në pikën 7 të Aneksit 2 të kësaj rezolute thuhet: "...vetëqeverisje substanciale për Kosovën, duke marrë parasysh në tërësi Marrëveshjen e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të vendeve tjera në rajon, dhe çmilitarizimin e UÇK-së...". Kjo pikë, pra pika 6 e aneksit 1 të Rezolutës 1244, gjegjësisht pika 7 e Aneksit 2 të kësaj rezolute, është edhe në tekstin, që me 3 qershor e ka miratuar Parlamenti i Serbisë dhe Presidenti Millosheviq²⁵. Nga kjo rrjedhë se Parlamenti i Serbisë dhe ish-Presidenti Millosheviq, me 3 qershor e kanë pranuar Marrëveshjen e Rambujesë. Zaten, intervenimi i NATO-s është bërë për t'u pranuar Marrëveshjen e Rambujesë²⁶, e kjo marrëveshje, siç thuhet, veç tjerash, në Kapitullin 7 të saj - Shtojcat - Shtojca B: Statusi i forcave implementuese multinacionale, pika 8, garanton që "personeli i NATO-s do të gëzojë së bashku me automjetet, aeroplanët, mbajtësit dhe mjetet e tij, qarkullim të lirë, të pakufizuar dhe hyrje të papenguar nëpër tërë RFJ-në, duke përfshirë hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale...".²⁷

Në vijim të kësaj, është absurde ajo që e thotë njëri nga kryesuesit e delegacionit kosovar në Rambujë se "bombardimet do të jenë të pashmangshme, në qoftë se diktatori i Beogradit nuk i pranon kërkesat e Bashkësisë Ndërkombëtare... Në qoftë se kjo është e vërtetë - e mund të jetë e vërtetë, ne do të jemi nënshkrues të Marrëveshjes pavarësisht çfarë do të jetë përmbajtja e saj (stërtheksimimi - Sh.G.)"²⁸ S'ka asnjë dyshim se kjo marrëveshje është kundërshtim frapant me Deklaratën Kushtetuese (2 korrik 1990); Kushtetutën e Kaçanikut (7 shtator 1990); Referendumin për pavarësi (26-30 shtator 1991), dhe me Deklaratën Politike nr 31 të SHP të UÇK-së, që është lëshuar në prag të shkuarjes së Delegacionit të Kosovës në Rambujë;²⁹ bile-bile, ajo është në kundërshtim edhe me betimin e ushtarit të UÇK... Ç'është më e keqja, Marrëveshjen e Rambujesë, e cila parasheh autonomi substanciale për Kosovën në kuadër të Serbisë dhe të Jugosllavisë, e ka votuar Parlamenti i Republikës së Kosovës³⁰, i cili ka funksionuar në bazë të Kushtetutës së Kaçanikut dhe i cili ka marrë obligimin që të jetësojë vullnetin e popullit të shprehur në referendumin e vitit 1991... Në bisedat që kam bërë me shumicën e

anëtarëve të Delegacionit të Kosovës në Rambuje, që të gjithë e pranojnë se Rambujeja është një dokument ambivalent, kontradiktor, madje edhe i keq, por, e mira e dokumentit të Rambujesë - thonë ata - konsiston në faktin se është dokument i përkohshëm, pra trevjeçar. Ç'është e vërteta, Marrëveshja e Rambujesë është dokument i përkohshëm, por jo trevjeçar. Në fund të dokumentit, nuk thuhet se dokumenti është trevjeçar, por se pas tre vjetëve do të thirret një mbledhje për të determinuar një mekanizëm për zgjidhjen finale për Kosovën.

KONKLUZIONI

Dallimi mes Marrëveshjes së Rambujesë dhe Rezolutës 1244 është fare i vogël - Marrëveshja e Rambujesë është e përfshirë në Rezolutën 1244. Por, në Rezolutën 1244 është shtuar vetëm tërheqja e forcave serbe nga Kosova, të cilat në bazë të pikës 5 të Aneksit 2 të Rezolutës 1244 do të mund të kthehen për të ushtruar funksionet që parashihen në Rezolutë. Siç vë në dukje edhe Chomsky³¹, sipas Marrëveshjes së Rambujesë nuk është paraparë të ketë trupa aq sa ka pasur në qershor të vitit 1999, kur është futur NATO në Kosovë. Pra, në Marrëveshjen e Rambujesë është paraparë që të ketë 28.000 trupa të NATO-s, ndërsa, në qershor, pas përfundimit të intervenimit të NATO-s kemi pasur 50.000 trupa. S'e besoj që mund themi se këtu ka ngritje për palën kosovare. Madje, po ashtu në Marrëveshjen e Rambujesë nuk është paraparë që Kosova të administrohet nga misioni i OKB-së³². Marrëveshja e Rambujesë është në Rezolutën 1244, dhe fakti që nuk ka forca serbe në Kosovë, nuk do të thotë se Marrëveshja e Rambujesë nuk është valide. Ajo marrëveshje është valide sepse 1244 i referohet në tërësi asaj.

Në Rezolutën 1244, për dallim nga Rambujeja jo vetëm që nuk ka ngritje për palën kosovare, por mjerisht, del se ka rënie, sepse, siç u tha më lart, në Rezolutën 1244 është dashur të merret parasysh parimi Rebus sic stantibus. Për dallim nga rezoluta 1244, rezoluta 1272³³ për Timorin Lindor, mandatin e misionit të OKB-së për Timorin Lindor - UNTAET, e përcakton kështu: që të përgatis popullin dhe territorin e Timorit Lindor për pavarësi. Andaj, me fjalë tjera, Rezoluta 1244 nuk e përcakton mandatin e UNMIK-ut për të përgatitur popullin dhe territorin e Kosovës për pavarësi, por, ashtu siç edhe thuhet në Marrëveshjen e Rambujesë, e përgatit atë për një autonomi substanciale. Për më tepër, edhe presidenti i atëhershëm amerikan, gjatë bombardimeve të NATO-s, në një fjalim drejtuar popullit serb, pat deklaruar: "atealët e NATO-s mbështesin popullin serb për ruajtjen e Kosovës si pjesë e vendit tuaj." (Henry Kissinger, "Dëmtimi i Historisë", botuar në librin "Lufta kundër luftës" në faqe 232-236.) Fare në fund, edhe nëse ka dallim mes Marrëveshjes së Rambujesë dhe Rezolutës 1244, ai është sekondar, për të mos thënë tercijar.

Shënime

1 Kadare, Ismail. "Ra ky mort e u pamë", Onufri, Tiranë, 2000, faqe 75.

2 Për më tepër shih: Demaçi, Adem., "Liria dhe joliria - përgjigje letrës së Veton Surroi" botuar nga interpres r.company, Prishtinë, 2002, ku Adem Demaçi akuzon nënshkruesit e Marrëveshjes së Rambujesë se kanë hequr dorë nga pavarësia e Kosovës dhe se atje kanë luajtur futboll me fatin e Kosovës...

3 Judah, Tim., "Kosova - lufta dhe hakmarrja", Koha, Prishtinë, 2002, faqe 243.

4 Gjatë intervistave që kam bërë me anëtarët e delegacionit kosovar në Rambuje, kam hetuar se shumica prej tyre nuk kanë njohuri se çfarë është parimi rebus sic stantibus, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk është bërë presion që ky parim të zbatohet.

5 Për më tepër, shih Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, gjegjësisht pikën 11 (a) të kësaj rezolute, ku thuhet se Këshilli i Sigurimit vendos që përgjegjësit kryesorë të forcës ndërkombëtare të përfshijnë: në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare, krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje substanciale në Kosovë, duke marrë tërësisht parasysh aneksin 2 dhe Marrëveshjen e Rambujesë. Kurse, paragrafi 4 i preambulës së Marrëveshjes së Rambujesë rikujton zotimin e bashkësisë ndërkombëtare për sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë.

6 Për më tepër, shih dialogun "Rambujeja kontestuese" që Omer Karabeg në radion e Europa e Lirë ka bërë në mes të Radoslav Stojanovic dhe Arsim Bajramit, më 9 prill 2000. Ky dialog



është botuar në magazinën URA, botim special, verë 2002, nr. 2-3, botuar nga Qendra për Studime Humanistike "Gani Bobi", Prishtinë, faqe 119-122.

7 Këtu tek annex 2 është fjala për aneksin 2 të Rezolutës 1244

8 Text of Serbia-Montenegro agreement Friday, 15 March, 2002, në: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/1874523.stm>

9 Për parimet tjera të panegociueshme, shih Petrisch, Wolfgang., Pichler, Robert. "Rruga e gjatë në luftë - Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 - 1999", Koha, Prishtinë, 2002, faqe 165.

10 Kështu ka deklaruar anëtarë të delegacionit kosovar, Hydajet Hyseni, në intervistë me autorin e kësaj eseje - "Marrëveshja e Rambujesë është e njëjtë me aktin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë".

11 Këtë e thotë edhe eksperti i delegacionit kosovar në Rambuje, Arsim Bajrami, në intervistën e zhvilluar nga autori i kësaj eseje. Për më tepër, ai thotë se në Rambuje ka pasur referendum.

12 Për më tepër, shih Shala, Blerim. "Vitet e Kosovës", Zëri, Prishtinë, 2000, faqe 263, ku Shala thotë se "O'Brien e cilësoi si të pagjasë insistimin tonë që këtu të precizohej se kemi të bëjmë me "vullnetin e popullit të Kosovës". Ndërsa, në 5 propozimet që Qeveria Amerikane kërkon nga delegacionin i Kosovës t'i shqyrtojë, propozimi i katërt thotë: "Të theksoni se ju besoni (stërtheqsimimi - Sh.G) se keni të drejtë të mbani referendumin..." - për të parë propozimet e Qeverisë Amerikane: Qosja, Rexhep., "Paqja e përgjakshme - Konferenca ndërkombëtare për Kosovën - Rambuje 6-23.02.1999 & Paris 14-19.03.1999", Toena, Tiranë, 1999, faqe 328.

13 Për të parë në tërësi letrën e Madeleine Albright: Tahiri, Edita., "Konferenca e Rambujesë - procesi negociator & dokumentet", Dukagjini, Pejë, 2001, 224

14 Cituar nga libri "Kosova - lufta dhe hakmarrja" i autorit Tim Judah, botuar nga Koha, Prishtinë, 2002, faqe 262

15 Në lidhje me letrën e sekretares amerikane Madeleine Albright, eksperti i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare - Enver Hasani, në intervistë me autorin e kësaj eseje thotë se: "Ne nuk na mbron ndërkombëtarisht deklarata e zonjës Albright, ngaqë ajo mund të jetë e tillë, pra deklarata mbrojtëse, vetëm nëse drejtohet ndaj shteteve sovranë dhe të pavarura..."

16 Shala, Blerim. "Lufta diplomatike për Kosovën - dialog me ambasadorin Christopher Hill", Zëri, Prishtinë, 2003, faqe 125.

17 Petrisch, Wolfgang., Pichler, Robert. "Rruga e gjatë në luftë - Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare 1989 - 1999", Koha, Prishtinë, 2002, faqe 269 - "Nëse pas dështimit të konferencës u tha se pas periudhës kalimtare trevjeçare kosovarëve u ishte premtuar një referendum, i cili do t'i çonte drejt pavarësisë, një gjë e tillë është thjesht e pasaktë."

18 Cituar nga Judah, Tim., "Kosova - lufta dhe hakmarrja", Koha, Prishtinë, 2002, faqe 259. Po ashtu Madeleine Albright, në takim me kryesinë e Delegacionit të Kosovës ka thënë: "Të pranosh referendumin, domethënë të pranosh pavarësinë e Kosovës, e kjo s'bëhet as nga ne, SHBA, as nga bashkësia ndërkombëtare"; shih Qosja, Rexhep., "Paqja e përgjakshme - Konferenca ndërkombëtare për Kosovën - Rambuje 6-23.02.1999 & Paris 14-19.03.1999", Toena, Tiranë, 1999, faqe 295.

19 Në dokumentin e Rambujesë, edhe shqiptarët, sikurse të tjerët, përfshirë serbët, romët... konsiderohen si bashkësi nacionale.

20 Hasani, Enver., "Uti Possidetis Juris: From Rome to Kosovo", botuar në "The Fletcher Forum of World Affairs", Massachusetts.

21 Shih Marrëveshjen e Rambujesë, kapitulli 1 neni 9 - Përfaqësimi. Po ashtu, shih: Disa vërejtje esenciale për projekt-propozimin e ofruar në Rambuje të Francës, Zyra e Adem Demaçit për analiza, propozime e këshilla politike, Prishtinë, 2 mars 1999. Vërejtja numër 4 thotë se Kosova nuk do të përfaqësohet në Dhomenë e Republikave të "RFJ"-së, por në dhomenë e Qytetarëve të "RFJ"-së. Kjo tani është më pak se Kushtetuta e vitit 1974.

22 Shih Marrëveshjen e Rambujesë, kapitulli 1, neni 2 - Kuvendi. Të përgjithshme, ku thuhet se bashkësia nacionale serbe dhe shqiptare supozohet se do ta arrijnë pragun e 5% të popullsisë.

23 Në Aktin Final të Helsinkut 1975, mes tjerash, thuhet se të gjithë popujt kanë të drejtë të vendosin lirshëm për statusin e tyre politik - <http://www.osce.org/docs/english/1990-1999/summits/helma75e.htm>

24 Kështu thotë Edita Tahiri, anëtare e delegacionit kosovar në Rambuje, në librin e saj "Konferenca e Rambujesë - procesi negociator & dokumentet", Dukagjini, Pejë, 2001, faqe 10. Po ashtu, në këtë libër thuhet se Konferenca e Rambujesë hapi shtegun për deklarimin e popullit të saj me referendum për statusin final të Kosovës si shtet i pavarur. Po të njëjtën gjë e thotë edhe në intervistë me autorin e këtij punimi. Kurse, këshilltari i Delegacionit të Kosovës në Rambuje, Enver Hasani, thotë se "në momentin që është parë se dispozitat e Rambujesë nuk garantojnë pavarësinë e Kosovës, atëherë tërë energjia sikur është kthyer kah njeri-tjetri. Kjo, në vijim të komentit tim sa më sipër, nuk don të thotë se është dëmtuar interesi nacional i Kosovës, shikuar sipas parametrave objektiv."

25 Teksti që Parlamentit serb e pat miratuar më 3 qershor është në web site-in: <http://jurist.law.pitt.edu/peace.htm#plan>

26 Kadare, Ismail. "Ra ky mort e u pamë", Onufri, Tiranë, 2000, faqe 75.

27 Për më tepër, shih Marrëveshjen e Rambujesë.

28 Këtë e thotë akademik Rexhep Qosja në librin "Paqja e përgjakshme - Konferenca ndërkombëtare për Kosovën - Rambuje 6-23.02.1999 & Paris 14-19.03.1999", Toena, Tiranë, 1999, faqe 194.

29 Në këtë Deklaratë politike thuhet se "Delegacioni i UÇK-së nuk do të pranojë asnjë zgjidhje që nuk do të krijonte mundësi reale dhe të sanksionuar qartë për të drejtën e popullit tonë për vetëvendosje - referendum"; kjo mund të shihet në librin: Baftiu, Fehmi., "Kosova krizë ndërkombëtare", Çlirim, 2004, faqe 336

30 Shih Qendra për Informim e Kosovës (QIK), Informatori ditor nr. 2351C, 6 mars 1999, 15:00 CET, Prishtinë.

31 Chomsky, Noam., "Another Way For Kosovo?", Le Monde diplomatique, 14 mars, 2000. Për më tepër, shiko: <http://www.chomsky.info/articles/20000314.htm>

32 Eksperti i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Enver Hasani, në bisedë me autorin e këtij punimi thotë se "tërë lufta e Millosheviqit është bërë për të lenë Kosovën nën mandatin e një organizate universale dhe të shkruar, siç është OKB-ja"... Intelektuali dhe regjisori Fadil Hysaj në intervistë me autorin e këtij eseu thotë se "në çdo vend ku ka qenë administrata e OKB-së ka ndodhur një degradim politik, ekonomik e moral deri në nivelet më të ulta..."

33 Rezoluta 1272 mund të lexohet në internet: <http://www.un.int/usa/sres1272.htm>

Samarxhiq, Bërns dhe Petersen

Shkëlzen Gashi

1. Sllobodan Samarxhiq, këshilltar i Kryeministrit të Serbisë, ka deklaruar të dielën se Qeveria e Serbisë mendon që raporti i ambasadorit Kai Eide në mënyrë korrekte ka vendosur bazat për bisedimet për statusin e Kosovës, në kontekstin e të drejtës ndërkombëtare dhe të statusit të Serbisë dhe Malit të Zi dhe se pret që Këshilli i Sigurimit i OKB-së më 24 tetor të japë dritën e gjelbërt për fillimin e bisedimeve rreth statusit të Kosovës - autonomi substanciale për Kosovën. Në anën tjetër, zyrtarë të Qeverisë Kosovës dhe të opozitës kanë thënë se Këshilli i Sigurimit (KS) i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në Nju Jork, do të sjellë vendimin për fillimin e bisedimeve rreth statusit politik të Kosovës. Bisedimet do të fillojnë. Pritja e zyrtarëve të Qeverisë Kosovës dhe të opozitës nuk do të jetë e kotë. Por, është me rëndësi të thuhet se baza do të jetë Rezoluta 1244. Serbët e Kosovës kanë vendosur që të jenë në delegacionin e Serbisë. Nuk është aspak e befasishme që në këtë mbledhje të rëndësishme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së nuk do të marrë pjesë askush nga Qeveria e Kosovës. Kosovën do ta përfaqësojë UNMIK-u sepse politika e jashtme është kompetencë e UNMIK-ut. Për më tepër, Kosova nuk është subjekt. Është objekt.

2. Gazeta prestigjioze amerikane The Washington Post në një editorial të saj në mënyrë shumë të qartë parashikon kompromisin që duhet të bëjnë shqiptarët dhe serbët për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Edhe më ashpër do të jetë mposhtja e rezistencës së shqiptarëve të Kosovës për të bërë koncesione për minoritetin serb - siç është lejimi i një autonomie të konsiderueshme për serbët që jetojnë si shumicë në rajone të caktuara. Në anën tjetër, nënkretari i Departamentit amerikan të Shtetit, Nikolas Bërns, në Paris ka thënë se status quo-ja në Kosovë nuk mund të jetë e qëndrueshme dhe ajo duhet të ndryshohet dhe se ne nuk e dijmë ku do të shpie ky proces, por ai duhet të çojë tek diçka më e mirë se sa është status quo-ja e cila nuk ka qenë e favorshme as për stabilitetin, apo për paqen në Kosovë. Stabiliteti regjional është faktori që po e shqetëson bashkësinë ndërkombëtare. Jo vullneti i popullit të Kosovës.

3. Integrimi i Kosovës në Evropë do të përshpejtohet nga një vendim i shpejtë që duhet marrë për statusin e saj ka thënë në Tiranë shefi i UNMIK-ut Soren Jessen Petersen pas takimit me kryeministrin e Shqipërisë Sali Berisha, dhe ka shtuar se në këtë proces të ri që hapet për Kosovën, qëllimi do të jetë stabilizimi i përgjithshëm i rajonit. Pra, prioritet, siç u tha edhe më sipër është stabiliteti regjional dhe jo vullneti i dy milionë qytetarëve të Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare, siç e kemi thënë shumë herë, konsideron se me bërjen e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran prishet edhe stabiliteti në Ballkan, ngase më pas do të kemi prishjen e kufijve në Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni... Në fakt, do të duhej të ishte e kundërta, pra, që prioritet t'i jipej vullnetit të popullit të Kosovës, ngase stabiliteti regjional do të çenohet po qe se zgjidhja e statusit final do të jetë në shpërputhje me vullnetin e popullit të Kosovës.

Absurditeti i IPVQ-ve

Mehmet Musaj

Për ekzistencialistin Albert Kamy, nëse diçka është absurde, atëherë kjo është e barsvler-shme me 'të pamundurën', por njëherësh është edhe 'kontradiktore'. Nëse unë shoh një njeri duke sulmuar me armë të ftohtë një grup mitraljerësh, do të mendoj se veprimi i tij është absurd. Por, ky veprim është i tillë vetëm për shkak të shpërpjesëtimit që ekziston midis qëllimit të tij dhe realitetit që e pret; të kontradiktës që unë mund ta shquaj midis forcës së tij reale dhe qëllimit që i ka vënë vetes. Gjithnjë sipas Kamys, ne e vlerësojmë një dënim si absurd, duke e ballafaquar me një dënim që në dukje është i merituar. Po ashtu, një vërtetim me metodën e absurditetit kryhet duke krahasuar rrjedhimet e këtij arsytimi me realitetin logjik që kërkohet të krijohet. Në të gjitha këto raste, nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, absurditeti do të jetë përherë e më i madh, në varësi të zmadhimit të distancës ndarëse midis elementeve të krahasimit. Pra, ndjenja e absurditetit nuk lindë nga hetimi i thjeshtë i një fakti ose një përshtypjeje, porse ai buron nga krahasimi midis një gjendjeje faktike dhe njëfarë realiteti, midis një veprimi dhe një bote që e tejkalon. Absurdi është në thelb një divorc. Ai nuk është tek asnjë nga dy elementet e krahasimit. Ai lind nga ballafaqimi i tyre. Ka martesë absurde, sfida, mëri, heshtje, luftëra, si dhe paqe. Por, ka edhe institucione politike absurde. Të tilla janë Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës. Për secilën nga këto, absurditeti lind nga një krahasim. Por, si mund të hetohet prania e absurdit brenda IPVQ-ve? Shumë thjesht. Vetëm duhet të krahasojmë synimet që ato pretendojnë t'i arrijnë me mundësinë për realizimin e atyre synimeve. Do të



Foto: Rrezeart Galica - Gijq

shohim se sa i pamundur është realizimi i tyre. Dhe njëkohësisht, do të shohim edhe shumë kontradikta, të cilat janë rezultat i këtij krahasimi. Kësisoj, vetë themelimi i këtyre institucioneve është absurd. Ai shpreh një shpërpjesëtim të madh midis vullnetit të popullit të Kosovës, dhe atij të bashkësisë ndërkombëtare. Baza juridike e tyre është Rezoluta 1244 dhe Korniza Kushtetuese, që assesi nuk janë vullneti i popullit të Kosovës. Por, më tepër janë shprehje e vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare. 'Puna' e tyre nuk duartroket nga populli i Kosovës, por nga UNMIK-u. Ato janë shndërruar në vegla të UNMIK-ut. Sa herë që IPVQ-të marrin vendime të cilat rezultojnë të jenë shprehje e vullnetit të popullit të Kosovës, ato ndeshin në një reagim pezmatues nga ana e UNMIK-ut; si rezultat i kësaj, ato vendime përfundojnë në shportë. Pra, shihet qartazi se çfarë shpërpjesëtimi ekziston në mes qëllimit të një vendimi të tillë dhe realitetit që e pret. Si dhe fare lehtë mund të hetohet situata kontradiktore, që na shpërfaqet në këtë rast, midis

forcës reale të IPVQ-ve dhe qëllimit që i kanë vënë vetes (kjo është njësoj sikur t'i biesh murit me kokë). Absurditeti i IPVQ-ve, ka marrë tatëpjetë sidomos kohëve të fundit, me aktualizimin e negociatave për statusin final të Kosovës. Në njërin anë, IPVQ-të deklarohen para mediave se nuk do të negociojnë për statusin e Kosovës (por vetëm për çështje teknike), ndërsa në anën tjetër tërë 'energji' e tyre është duke u shpenzuar në procesin i cili çon drejt atyre negociatave. Sërisht, ne mund të shohim se ajo çka këto institucione pretendojnë të bëjnë, është e pamundur dhe njëherësh kontradiktore, me një fjalë është absurde. Kjo pamundësi vjen duke krahasuar veprimin e tyre dhe procesin që e tejkalon këtë veprim. Kështu që, distanca në mes elementeve që ne krahasojmë, IPVQ-ve në njërin anë dhe misionit e vullnetit që ato shprehin në anën tjetër, është vazhdimisht në rritje. Parë nga ky prizëm i absurditetit, ekzistenca e IPVQ-ve rezultojnë të jetë më tepër e dëmshme sesa e dobishme!

Lëvizja Vetëvendosje!

Ne çjerrim maska

Sqarim për opinionin e gjerë

Kur një Lëvizje përjeton zgjerim e rritje, është në natyrën e kundërshtarëve të saj ta pengojnë zhvillimin e saj. Ja përse, tash për tash, këto gjëra po i ndodhin vetëm Lëvizjes sonë. Dikush përpiqet t'i infiltrojë njerëzit nëpër strukturat tona, dikush nëpër aksionet tona, duke tentuar t'ua devijojë atyre qëllimin e mirë, e dikush tjetër duke bërë qëllimshëm veprime të pahijshme nën emrin e VETËVENDOSJE!-s. Madje, diku-dikush po themelon edhe formacione që vetëshpallen ushtri, të cilave po u pëlqen të identifikohen me këtë emër. Po jo vetëm kaq: kohëve të fundit dëgjuam që grupe njerëzish të maskuar, nëpër disa rajone të vendit, po i ndalojnë njerëzit në qarkullim e sipër, në emër të VETËVENDOSJE!-s dhe kundërshtimit të negociatave.

Le ta sqarojmë këtë gjë një herë e mirë: Lëvizja VETËVENDOSJE! dënon ashpër çfarëdo ndërmarrje kaq të papërgjegjshme të njerëzve apo grupeve, të cilat keqpërdorin emrin e Lëvizjes në mënyrë kaq të paturpshme. Askush nuk qëndron prapa Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Lëvizja jonë nuk qëndron prapa askujt. Në jemi në ballë, sepse ky sistem duhet përballur.

Në Kosovë pushteti është tepër i padrejtë dhe robëria shumë e rëndë, për ta kundërshtuar atë fshehurazi. Ky sistem politik duhet kundërshtuar haptazi. Kurse, ky mjedis politik-shoqëror ka hapësirë të mjaftueshme për organizim dhe aksion gjithpopullor të padhunshëm. Këtij sistemi fundin do t'ia sjellin potencialet njerëzore të popullit.

Në kohën kur po përgatitet realizimi i copëtimit të vendit përmes decentralizimit dhe kompromisi me Serbinë për Kosovën, armiku më i madh i regjimit aktual është mobilizimi dhe organizimi i përgjithshëm i popullit. Kosova jorastësish është mbushur me postbloqe, që për pretekst i kanë maskat. Ne jemi kundër maskave, sepse ne i çjerrim maskat - qofshin ato ndërkombëtare apo vendase.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

VETËVENDOSJE!

**KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!**

Rr. Perandori Justinian, p. n.
Qyteza Pejton
Prishtinë, Kosovë

038 222 704
vetevendosje@hotmail.com
vetevendosje@yahoo.com
vetevendosje@gmail.com
www.vetevendosje.org